



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. Prot 2456

01- 26.10.20

VENDIM

Nr. 52, datë 26 . 10 .2020

PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT, VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË KANDIDATURËS SË ZONJËS ARDITA ALSULA (BUNA), PËR SHKAK TË TËRHEQJES NGA KANDIDIMI PËR INSPEKTOR JO-MAGJISTRAT

KOMITETI I EMËRIMIT EDHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE i përbërë nga :

Artur Metani - Kryetar
Mirela Kapo - Anëtare
Marsela Pepi- Anëtare

Asistuar nga sekretare Adela SKORA,

në mbledhjen e datës 26.10.2020, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATI PËR INSPEKTOR
JO - MAGJISTRAT:**

ZONJA ARDITA ALSULA (BUNA)

OBJEKTI:

Tërheqje nga kandidimi për Inspektor Jo magjistrat

KOMITETI PASI :

U njoh me aktet si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në datë 07.02.2020, ka vendosur fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatëve jomagjistratë që kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim datë 02.03.2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nëpërmjet Njoftimit për Media në faqen zyrtare ka bërë publike listën e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë vend vakant, duke filluar shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenit 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant për Inspektor jomagjistratë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është edhe Zonja ARDITA ALSULA (BUNA). Konkretisht kërkesa e kandidatit për shprehje interesi mban nr. Prot, 351 datë 27.02.2020.

4. Në zbatim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të gërmës A, pikës 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbledhjen e zhvilluar në datën 07.02.2020, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant për Inspektor jomagjistratë pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5. Lidhur me procedurën e ndjekur për vendet vakante të krijuar për Inspektor jomagjistratë, nga Inspektori i lartë i Drejtësisë, në zbatim të nenit 209 dhe 211 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 3 dhe 77, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është përcaktuar axhenda që lidhet me rradhën e shqyrtimit të kandidaturave.

6. **Zonja ARDITA ALSULA (BUNA)**, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar për Inspektor, në mbështetje të nenit 209 dhe 211, pika 2 e ligjit nr. "115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77 të vendimit nr. 536 datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "*Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit*", është njoftuar, për tu paraqitur pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati **ARDITA ALSULA (BUNA)**, gjendet e administruar në dosjen e kandidatit.

7. Në vijimësi të procesit, kandidati **ARDITA ALSULA (BUNA)** është njoftuar për tu paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe për tu pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure (në rrugë elektronike) vërtetohet nga email-i përkatës dhe i konfirmuar edhe nga përgjigja e vetë kandidatit po me email, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit. Gjithashtu nëpërmjet "Deklaratës së datës 24.04.2020" vetë kandidati është paraqitur personalisht për marrjen e formularëve përkundëjt nënshkrimit.

8. Në datën 30.04.2020 kandidati **ARDITA ALSULA (BUNA)** ka depozituar në sekretarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, formularët e deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

9. Kandidati **ARDITA ALSULA (BUNA)** ka njoftuar nëpërmjet "kërkesës për tërheqje nga procedura e konkurimit për pozicionin Inspektor jo magjistrat", Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë se me vullnetin e tij të lirë, tërhiqet nga kandidimi për vendin e Inspektorit jomagjistrat. Kjo kërkesë është dërguar nëpërmjet adresës së emailit arditaalsula@yahoo.com, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit. Gjithashtu nëpërmjet kësaj kërkesë kërkohet nga ana e kandidatit të njihet me dokumentacionin e dosjes së saj (pa vendosur bazë ligjore).

10. Në lidhje me rastin e tërheqjes nga kandidimi, në vendimin nr. 536 datë 25.7.2019 që lidhet me "*Krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit*", në pikën 7 të tij, parashikohet se :

"7. Kandidati jomagjistrat ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Inspektorin. Pas këtij njoftimi, Inspektori vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit jomagjistrat. Akti i Inspektorit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit jomagjistrat dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë."

11. Lidhur me kërkesën e bërë nga ana e kandidatit për të marë një kopje të dokumentacionit, në zbatim të gërmës B, që lidhet me të drejtat e kandidatit, në pikën 5 të Vendimit nr. 536 datë 25.07.2019 që lidhet me "*Krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit*" është parashikuar se :

5. Kandidati jomagjistrat ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së verifikimit, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga Inspektori për verifikimin e plotësimin të kushteve e të kriterëve ligjore si dhe të verifikimit të figurës e të pasurisë së kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar dhe atyre të përcaktuara në këtë vendim. Në këtë kuadër, kërkesa e bërë nga ana e kandidatit legjitimohet për sa më sipër.

12. Në përfundim të njohjes së anëtarëve me materialet që përmban dosja e kandidatit ARDITA ALSULA (BUNA) dhe në mënyrë të vecantë shprehjen e vullnetit të saj, në zbatim të pikës 7 të Vendimit nr. 536 datë 25.07.2019 që lidhet me “Krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit”, është proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm, si dhe për shqyrtimin e kërkesës së kandidatit, duke kaluar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Komitetit.

13. Në zbatim të Vendimit nr. 536 datë 25.07.2019 që lidhet me “Krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjorë, verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Komitetit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 26.10.2020, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt tërheqjen nga kandidimi të zonjës ARDITA ALSULA (BUNA), për vendin vakant për Inspektor, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në datën 07.02.2020.

14. Sikundër u tha më sipër, nga aktet rezulton se zonja ARDITA ALSULA (BUNA) është paraqitur fizikisht pranë ambienteve të zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qëllim tërheqjen e formularëve përkatës, ky fakt rezulton se është kryer nga ana e kandidatit ARDITA ALSULA (BUNA) në datën 24.04.2020. Në datën 30.04.2020 ky kandidat ka dorëzuar formularët e plotësuar konform ligjit. Nëpërmjet kërkesës për tërheqje nga procedura e konkurimit për pozicionin Inspektor jo magjistrat”, Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë se me vullnetin e saj të lirë, tërhiqet nga kandidimi për vendin e Inspektorit jo- magjistrat. Kjo kërkesë, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

15. Në mbledhjen e Komitetit, pasi secili prej anëtarëve u njoh me aktet e administruara në fashikullin që lidhet me kandidimin e zonit ARDITA ALSULA (BUNA) si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi, u arrit në konkluzionin se:

Vlerësimi i Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:

16. Komitetit i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të sipërcituara si dhe bazuar në gjëndjen që janë aktet që lidhen me ndjekjen e procedurave për vendin vakant për Inspektorët Jomagjistrat të shpallur nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në datën 07.02.2020, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për përfundimin e procedurës administrative që lidhet me kandidatin ARDITA ALSULA (BUNA).

17. Në pikën 2 të nenit 211 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikohet se:

“2. Inspektorët e tjerë emërohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në bazë të një procedure përzgjedhëse dhe konkurruese të hapur dhe të planifikuar. Jo më vonë se 3 muaj nga krijimi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Lartë miraton rregulla më të hollësishme për procedurën e përzgjedhjes, konkurrimit dhe emërimit të inspektorëve jomagjistratë. Rregullat e miratuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë zbatohen, për aq sa është e mundur, me rregullat e ligjit “Për nëpunësin civil”. ”.

18. Në zbatim të nenit 209 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në përfundimit të afatit të caktuar të shpalljes “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes në Pozicionin Vakant Inspektor jo magjistratë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, pasi ka administruar dokumentacionin e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë pozicion, ka filluar procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e kushteve dhe kriterëve të kandidimit që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji.

19. Ligji nr. 115/2016 nuk parashikon në mënyrë të shprehur rastin e tërheqjes nga kandidimi dhe mënyrën e disponimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në raste të tilla.

20. Por, nga ana tjetër, Ligji nr. 115/2016, në pikën 2 të nenit 209, parashikon se :

2. Inspektorët e tjerë emërohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pas këshillimit me Komitetin e Emërimit dhe të Vlerësimit të Inspektorëve, në bazë të një procedure përzgjedhëse të hapur, konkurruese dhe të planifikuar, në analogji, për aq sa është e mundur, me rregullat e ligjit “Për nëpunësin civil”.

21. Bazuar në këtë detyrim dhe delegim ligjor për të miratuar, në bazë dhe për zbatim të ligjit, rregulla më të detajuara normative, konkretisht në vendimin nr. 536 datë 25.7.2019 që lidhet me “Krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit”, në pikën 7 të tij, parashikohet se :

“7. Kandidati jomagjistrat ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Inspektorin. Pas këtij njoftimi, Inspektori vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit jomagjistrat. Akti i Inspektorit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit jomagjistrat dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.”

22. Gjithashtu në pikën 24 të vendimin nr. 536 datë 25.7.2019 që lidhet me “Krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit”, parashikohet se:

“24. Kur kandidati jomagjistrat njofton tërheqjen nga kandidimi, Inspektori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projektaktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit jomagjistrat të tërhequr.”

23. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore dhe atyre nënligjore normative të zbatueshme në rastin e tërheqjes nga kandidimi, vlerëson të rregullt procedurën e ndjekur deri tani për verifikimin e kandidaturës së kandidatit ARDITA ALSULA (BUNA). Kandidati është njoftuar rregullisht për fillimin e kësaj procedure në datë 13.08.2020 me vullnetin e saj të lirë ka njoftuar “tërheqjen nga kandidimi”.

24. Gjithashtu, nga aktet që përmban dosja e kandidimit, rezulton që kandidati ARDITA ALSULA (BUNA), ka paraqitur një kërkesë për heqje dorë nga kandidimi për pozicionin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, Ky komunikim gjendet i administruar në dosjen e kandidatit.

25. Komiteti vlerëson të rregullt në aspektin e qartësisë së vullnetit të shprehur prej këtij kandidati për tërheqjen nga kandidimi, shkresën e paraqitur për këtë qëllim nga kandidati ARDITA ALSULA (BUNA).

26. Komiteti vlerëson që shprehja e interesit dhe kandidimi për plotësimin e vendeve vakante që krijohen për Inspektor jo magjistrat pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një e drejtë, e cila ushtrohet nga kandidatët ekskluzivisht mbi vullnetin individual të tyre, duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e kandidimit që parashikon Kushtetuta dhe ligji.

27. Në rast se personi që kandidon, në çdo kohë e gjendje të procedimit, shpreh vullnetin për të mos vijuar më tej me kandidimin për plotësimin e vendit vakant që krijohet për Inspektor jo magjistrat pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, atëherë nuk ka më vend të vijojnë procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës, të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, pikës 7 dhe 24, të Vendimit Nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, Urdhrit Nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës së zonjës ARDITA ALSULA (BUNA), **për shkak të tërheqjes nga kandidimi** për vendin vakant Inspektor jo magjistrat pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Në zbatim të pikës 7 të vendimit nr. 536 datë 25.07.2019 që lidhet me “Krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve

ligjore, verifikimin e figurës dhe të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit”, ky vendim i njoftohet kandidatit **ARDITA ALSULA (BUNA)**.

3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën kompetente, brenda afatit ligjor.

4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, konkretisht në faqen www.ild.al.

ANËTARE

Marsela PEPI

ANËTARE

Mirela KAPO

KRYETARI

Artur METANI

